

Njoftim

Sot, më datë **24.04.2023, ora 15:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Manjola Xhaxho (Relatore);**
- 2. Emona Muçi (Anëtare);**
- 3. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 4. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 5. Blerona Hasa (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.16 Regj.Themeltar, Datë 21.04.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Indrit Sefa.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ.

Person i interesuar: Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga Av. Andi Skenderi dhe Av. Maringlen Legisi.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 60, datë 19.04.2023 të KAS "Për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 49, datë 17.04.2023, të depozituar nga "Partia Demokratike e Shqipërisë".

Shfuqizimi i vendimit nr. 366, datë 15.04.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar të Bashkisë Mallakastër, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

Ndalimin e kandidimit të Kandidatit për kryetar Bashkie të Mallakastrës, shtetasit Qerim Ismail Ismailaj, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja "n", e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neneve 2 dhe 4 të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të Kreut V, pikat 5 dhe 12 të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 "Për

garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

me Vendimin Nr. 16, datë 24.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjqësor, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 24.04.2023.

Tiranë, më 24.04.2023.

Gjykata Administrative e Apelit